



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.382/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Llazić, Afjete Sada – Gllogjani, Kymete Kicaj, Zyhdi Haziri, Rustem Thaqi, Ferki Xhaferi, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me apelin e Organizatës GERMIN, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos procedimit të 1.806 pakove, të votuesve jashtë Kosovës si fletëvotime të rregullta dhe mos numërimit të të njëjtave në Q.N.R, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 03.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli i paraqitur nga Organizata “GREMIN”, me seli në Prishtinë, Anr.382/2019 e datës 02.11.2019, me të cilën ka kërkuar që bazë të aktgjykimeve të A.A.UZH.nr.20/2019 dhe A.A.UZH.nr.19/2019 të Gjykatës Supreme, të ndërmarr veprime konkrete dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për të numëruar 1806 (njëmijë e tetëqind e gjashtë), pako të mbetura me fletëvotime të ardhura përmes postës.

A r s y e t i m

Me datën 02.11.2019, PZAP-i, ka pranuar apel Anr.382/2019, të parashtruar nga Organizata GERMIN, në të cilën thekson se vëzhguesit e Organizatës GERMIN kane vërejtur se KQZ nuk po e zbaton plotësisht vendimin A.A.UZH.nr.20/2019 të Gjykatës Supreme, lidhur me pranueshmërinë e votave në fjalë. KQZ nuk i ka procesuar fare 1,806 pako me fletëvotime nga diaspora të cilat kanë arritura mes dt. 11.10.2019, ditën kur është ushtruar ankesa ndaj PZAP, nga subjekti politik LVV, e cila ka sjell deri tek vendimi i Gj. Supreme, për pranueshmërinë e fletëvotimeve të ardhura me postë pas ditës së zgjedhjeve, deri më dt. 17.10.2019. Më tutje theksohet se veprimi i KQZ-ës nuk është në përputhje me aktgjykimin A.A.UZH.nr.20/2019 të Gjykatës Supreme ngase 1,806 pakot e pa trajtuara të fletëvotimeve nga bashkëqytetarët tanë që jetojnë jashtë vendit janë refuzuar pa kaluar asnjë procedurë verifikimi. Sipas parashtruesit të apelit të gjitha këto pako janë nisur si dërgesa postare para afatit përfundimtar për dërgimin e pakove postare të vendosura nga KQZ, përkatësisht nga dt. 19.09.2019, deri 05.10.2019, gjë që mund të vërtetohet në bazë të vulës postare në datën e nisjes. Me propozim që aktgjykimet të A.A.UZH.nr.20/2019 dhe A.A.UZH.nr.19/2019 të Gjykatës Supreme, të ndërmarr veprime konkrete dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për të numëruar 1806 (njëmijë e tetëqind e gjashtë), pako të mbetura me fletëvotime të ardhura përmes postës

Në përgjigje në ankesë KQZ pas shqyrtimit të apelit dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e palës në fjalë, thekson se në bazë të nenit 119 par.1, ku thuhet se

“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas ligjit, ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë pranë PZAP-së”. Më tutje theksojnë se kjo organizatë nuk është palë në procedurë, dhe nuk iu është shkelur asnjë e drejtë ligjore.

Paneli, në kuptim të nenit 3 paragrafi 8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, këtë ankesë e trajtojë si apel, duke konsideruar se në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat.

Paneli, në rishqyrtim pasi vlerësoi pretendimet e palëve në procedurë, provat që gjenden me shkresat e lëndës, gjeti se:

Apeli është i palejuar.

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese se KQZ, nuk po e zbaton plotësisht vendimin A.A.UZH.nr.20/2019 të Gjykatës Supreme, lidhur me pranueshmërinë e votave në fjalë, nuk mund të jenë objekt i vlerësimit, për faktin se PZAP, merr vendime në kuadër të autorizimeve ligjore dhe në këtë rast i njëjti nuk ka urdhëruar KQZ-në, që të ndërmarr ndonjë veprim por këtë e ka bërë Gjykata Supreme, prandaj Paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që të bëjë vlerësimin rreth zbatueshmërisë së Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, mbi këto arsye paneli, vendos vetëm ndaj vendimeve të KQZ-së ashtu siç parashihet me neni 122 paragrafi 1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i, i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me apelin e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa

Anr.382/2019 më datën 03.11.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.